

TRASHËGIMIA (pjesa 3)

Besim Që Duket

Mirë se erdhe në pjesën e tretë të serisë “Trashëgimia”.

Javën e parë folëm për sfidën e brezit të tretë. Është e vështirë të pasosh diçka deri në brezin e tretë, por jo e pamundur. Brezi i parë fillon diçka me mund të madh, brezi i dytë e gjen gati dhe mundohet ta mirëmbajë, por i bie vizioni, flaka, zjarri dhe vrulli. Brezi i tretë, kur shikon që prindërit e tyre janë të vakët, s’e duan fare atë gjë. Kërkojnë gjëra të tjera. Është e njëjta sfidë kur vjen puna për të pasuar besimin që ke ti te brezi tjetër.

Javën e dytë folëm si të trashëgojmë vlerën që:

Çdo gjë i përket Zotit;

Gjërat arrihen me punë dhe mund;

Si të mësojmë bujarinë;

Të jemi të kënaqur me ato që kemi dhe kjo gjë fillon me mirënjohjen. Nëse s’ka mirënjohje do mendojnë që ti ua ke për detyrë.

Sot do shikojmë si të kemi në vete një “Besim të Zjarrtë”, që brezi tjetër ta shikojë dhe ta dëshirojë atë që kemi ne.

Dua të kthehem te Psalmi 112, ja se çfarë tha Davidi:

Psalmi 112:1 “Lum njeriu që ka frikë nga Zoti dhe gjen një gëzim të madh në urdhërimet e tij.”

Psalmi 112:2 “Pasardhësit (fëmijët) e tij do të jenë të fuqishëm mbi tokë, brezat e njerëzve të drejtë do të jenë të bekuar.”

Çfarë thotë vargu? Pasardhësit, fëmijët e tyre do të jenë të fuqishëm mbi tokë.

Psalmi 112:3 “Në shtëpinë e tij ka bollëk dhe pasuri dhe drejtësia e tij vazhdon përjetë.”

Vazhdon përjetë! Shumica e njerëzve pasi vdesin, pak gjëra të tyre vazhdojnë gjatë. Por ne duam ta jetojmë atë lloj jete në mënyrë që vlerat dhe gjërat që i çmojmë si të rëndësishme të vazhdojnë edhe pasi ne të kemi ikur nga kjo tokë.

Kjo është trashëgimia jonë kryesore, këto janë vlerat tona që duam t’ia pasojmë brezit tjetër.

Psalmi 112:4 “Drita lind në terr për ata që janë të drejtë, për njeriun e dhembshur, të mëshirshëm dhe të drejtë.”

Janë të dhembshur, bujarë, të mirë, të drejtë, janë “si shpirt”!

Psalmi 112:6 “sepse nuk do të lëvizet kurrë; i drejti do të kujtohet gjithnjë.”

Nuk do të lëvizet kurrë, do të zgjasë, do të mbetet trashëgimia e tyre.

Ja ta përtypim edhe një çikë më shumë vargun 2 sot:

Psalmi 112:2 “Pasardhësit (fëmijët) e tij do të jenë të fuqishëm mbi tokë, brezat e njerëzve të drejtë do të jenë të bekuar.”

Fëmijët e tyre do të jenë të fuqishëm, do të jenë të suksesshëm kudo që janë!

Për mua, si prind, ky është një synim shumë i madh dhe i bukur. Kush do e donte PËR VETE këtë synim për brezin e fëmijëve që ka ose që do të ketë?

Ajo që është e rëndësishme për ne, si ndjekës të Krishtit, është ta shikojmë me nge.

Çfarë do të thotë të jesh i fuqishëm, i suksesshëm? Si matet kjo gjë? A ka lidhje me atë që thotë shumica? Çfarë thotë shumica?

Të jesh i “suksesshmi” i lagjes, “i fuqishmi” i lagjes, do të thotë se: Ti ke shumë gjëra dhe ke një familje të lumtur gjithmonë, fëmijë të lumtur gjithmonë dhe me nota të mira në të gjitha lëndët.

Tani pyetja është, a ka të tillë? I kanë të gjitha? Janë të lumtur gjithmonë? I kanë të gjitha 10-ta dhe çdo gjë ju shkon vaj?

Po nëse janë me 10-ta, por s’kanë ndërtuar karakter dhe s’kanë integritet, a quhen më të suksesshëm dhe më të mirët?

“Të lumtur”. Duket sikur po adhurohet lumturia, veç të jemi të lumtur:

“S’ka gjë, me çfarëdo çmimi do e paguajmë, veç të jemi të lumtur. Pesë punë do bëjë mami, vetëm që ti të jesh i lumtur.”

Problemi është se Perëndia nuk na ka thirrur që të jemi të lumtur, por na ka thirrur:

Të Jemi Të Shenjtë, Siç Është Ai I Shenjtë.

Lumturia nuk mund të jetë synimi ynë përgjithmonë, sepse gëzimi dhe lumturia janë produkte kur e jetojmë jetën me synime që e nderojnë Perëndinë. Do e kemi mendjen jo vetëm tek lumturia e sotme, por edhe te gatishmëria për të nesërmen.

Që brezi ynë dhe brezi pas nesh ta kenë synim parësor:

Si Të Nderojnë Emrin e Zotit Së Pari.

Po mirë, si ta përkufizojmë suksesin? Ndjekësit e Krishtit, ne vetë dhe brezi pas nesh e kanë:

Jezus Krishti, Zot dhe Shpëtimtar.

Dhe kjo e vërtetë është e rrënjësuar thellë tek ata.

Si Shpëtimtar, ne e dimë, brezi tjetër e di dhe ata pas tyre e dinë gjithashtu. Vetëm Jezusi shpëton, nuk ka rrugë tjetër.

Si Zot, ne i bindemi dhe e nderojmë atë në çdo gjë.

E dimë që vetëm Ai na shpëton. E nderojmë në jetën e përditshme si: zotëria jonë, si Zoti ynë, si pronari ynë, si shefi jonë, si “Top G” jonë.

Gjithnjë e më shumë besimi dhe çdo gjë po bëhet relative.

“Mirë, mirë, ti beson kështu, por mund të jetë edhe ashtu.

Edhe Krishti i mirë është, por edhe kisha e Lacit nuk është keq. Edhe të shkosh në xhami nuk është keq, edhe të shkosh te mali i Tomorrit nuk është keq, por edhe të besosh yjet dhe horoskopin nuk është keq, të mbash diçka për fat dhe për syrin e keq, nuk është keq...”

Kjo do të vijë duke u shtuar, është shtuar, por do të shtohet akoma më shumë.

A mund ta kemi të qartë vetë, me zero tolerancë dhe ta pasojmë te brezi tjetër këtë të vërtetë të fortë?

Në çdo bisedë, në kafe, në shtëpi, te puna dhe ta ngrejmë zërin: *“Dakort, e respektoj atë që thua ti, poooor, unë besoj...”* - dhe thuaje, lëri me diçka.

Vetëm Jezusi Është Zot dhe Shpëtimtar

Ja pse bëjmë kishë ne:

Si kishë, ne shërbejmë me pasion që çdo njeri **ta njohë** Jezusin, **të bëhet** më shumë si Ai, **të jetojë** një jetë pa frikë dhe **të sjellë** ndikim pozitiv aty ku është.

A i shikon katër foljet me të zeza: **ta njohë, të bëhet, të jetojë, të sjellë**? Këto janë shkallët. Së pari, a e njohin të gjithë Krishtin te familja jote? Nëse jo, lutu për ta, folu atyre. E dyta, cilat janë mënyrat që ti dhe familja jote të bëheni si Ai? E treta, si të jetojmë pa frikë, në qytetin tonë me kaq shumë ngarkesa, tensione dhe frikëra? E fundit, jemi lidera, kudo që ndodhemi, sjellim ndikim, nuk presim të ndikohemi, por e sjellim ne ndikimin aty ku jemi.

Yyy sa shumë gjëra! A të duken shumë ty? Si praktikohen, si bëhen në jetën e përditshme këto? Dua ta them me copa, me “kafshata të vogla”, sepse dua që secili të inkurajohet për t’u përdorur nga Perëndia për ta fuqizuar brezin e ri. Që ta duan atë që ke ti, ta dëshirojnë atë që ke ti dhe ta kenë atë që ke ti!

Shiko, kur mendon për vete dhe brezin tjetër, mendoje kështu: Ne dhe ata do të bëhemi sipas vendeve ku shkojmë, ku rrimë. Për shembull, nëse do që të bëhesh futbollist ose fëmija yt të bëhet i tillë, u ble një top futbollit, i çon te fusha e futbollit/ kalçeto, i fut në një ekip... e njëjta gjë edhe për basketbollin. Dhe gjasat janë që ata do e duan topin më shumë sesa librat e shkollës, sepse do fillojnë të bëjnë sipas vendeve ku kalojnë kohën, sipas njerëzve me të cilët rrinë. Si thuhet te:

Fjalët e Urta 13:20 – *“Kush shkon (rri) me të urtët bëhet i urtë, por shoku i budallenjve do të bëhet i keq.”*

Me kë të rrinë, ashtu do të bëhen!

Shiko, jeta sjell lloj-lloj gjërash: sherre te shkolla, sjellje jo të mirë, biseda dhe video për seksin, materializmin, gjykimin, bullizmin etj, etj...

Ne duam që brezi tjetër të zgjedhi Jezusin në këtë lumë zgjedhjesh që do t’u vijë para dhe puna jonë është t’i ekspozojmë ne këto përjetime. Në mënyrë që ata ta zgjedhin vetë Jezusin, jo sepse ashtu i thotë babi, mami, motra apo vëllai, por të duan vetë të rriten në Zotin. Të dinë kush janë në Zotin, që të mos kenë frikë gjërat pa lidhje, por ta dinë që janë lidera aty ku ndodhen dhe janë për të ndikuar të tjerët, jo të bien pre e ndikimit të tyre.

Puna jonë është të sigurohemi a i dinë ata këto gjëra, a janë të ekspozuar mjaftueshëm për t’i bërë këto zgjedhje.

Po si bëhet kjo? E para, do e ekspozojmë brezin tjetër për ta parë, për ta ndjerë dhe për ta përjetuar:

Gëzimin Që Vjen Kur E Njeh Personalisht Perëndinë.

Ja si e tha Jezusi këtë te Gjoni 17:

Gjoni 17:3 “...kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë...”

Përshkrimi i jetës së përjetshme - të njohësh Atin Perëndi!

Nganjëherë na bie më mirë t’i japim brezit tjetër një set rregullash: *“bëj këtë, mos bëj atë, se kështu thotë Bibla, se kështu thotë Zoti.”* - dhe nuk u theksojmë miqësinë me Perëndinë.

Por brezit të ri, po u dhe shumë rregulla, natyrshëm do të duan të rebelojnë. Dhe në fakt, brezi i ri që nuk vjen në kishë largohet prej saj më shumë prej rregullave, por nuk do të thotë që po largohen nga Krishti.

Le ta theksojmë, le t’i ekspozojmë, t’u japim mundësi që të kenë miqësi të sinqertë dhe personale me Perëndinë, ata vetë.

Si mund të bëhet nga ana praktike? Sa herë që ndodh diçka e mirë në familje, atribuojta Perëndisë në sy të tjerëve, të fëmijëve.

- Sa shumë na ka bekuar Zoti, sa i mirë është Ai me ne!
- Faleminderit Zotit për ty bir/ bijë, për shkollën, punën, shtëpinë, gjërat...
- S'e kishim këtë gjë, tani e kemi, faleminderit Zotit!
- Shiko si na ka bekuar Perëndia sot!
- Po hamë drekë në Durrës, faleminderit Zot për këtë mundësi!
- Jemi gjallë sot, faleminderit Zotit për këtë ditë!
- Na bëri dhuratë dikush, faleminderit Zot që na ke dhënë miq të mirë!
- Na erdhi një mundësi e mirë pune/ shkolle/ jete, faleminderit Zot për favorin...

Lidhi bekimet e jetës me burimin e bekimeve, që është Perëndia, sepse:

Çdo gjë e mirë vjen nga Ai

Bëje refren këtë gjë, që ta dëgjojnë ata që janë me ty.

Tjetra: Bisedoni bashkë për Perëndinë, lutuni bashkë kur jeni në shtëpi ose kur jeni nisur për rrugë.

Lexojeni Biblën/ pjesë të Biblës bashkë dhe me nxitje, “si e mendon këtë varg, po ti si e mendon?”.

Jini të qëllimshëm te shtëpia juaj për këtë gjë, sepse nuk ndodh vetvetiu, për arsye se ka shumë gjëra që të marrin vëmendjen, ka programe në TV, telefoni gjithë kohës etj.

Nganjëherë, për familjen time, një nga kohët më të bukura dhe të qeta janë kur jemi në makinë. Gruaja ime thotë: “Tani t’i lëmë telefonat dhe të lutemi, por më parë le të lexojmë vargun e ditës ose lexojmë një kapitull te Fjalët e urta”.

Gjithë gjithë kohës gruaja ime do ta gjejë një mundësi për t’i orientuar fëmijët tanë ose te Bibla, ose te lutja.

Shiko se mos më keqkuptoni, nuk jemi shumë “shenjtorë” ne tek shtëpia jonë, nuk ngrihem në pikë të mëngjesit dhe të gjithë me Bibël në dorë të qëndrojmë 10 orë duke u lutur.

Ka ditë të bukura dhe ka ditë që harrojmë plotësisht.

Ka ditë që është e “ftohtë” lutja dhe leximi i Biblës.

Nuk është fikse, nuk lutemi vetëm kështu apo vetëm ashtu.

Lutje sipas situatës: Lutemi se kanë fëmijët një provim, lutemi kur dëgjojmë për dikë që ka një siklet, lutemi kur kemi një hall, lutemi kur fëmijët tanë zihen me njëri-tjetrin, lutemi sa herë që shohim një moment.

Por janë momentet e thjeshta. Mbjaj mend kur ishin të vegjël fëmijët e mi kur luteshim para ushqimit, ndonjëri po hante ndërsa luteshim, ose nuk donte t’ia kapte dorën vëllait sepse sa ishin zënë.

Jini të sinqertë kur luteni, lutuni me fjalë të përditshme. Jo me fjalë të mëdha që duken si “poema e Gjergj Fishtës”!

Por lutje të sinqerta dhe sa herë që Zoti e plotëson atë lutje, fëmijët, ne vetë krijojmë lidhje personale e të sinqertë me Perëndinë.

Nëse do që fëmijët të kenë lidhje të ngushtë me Fjalën e Perëndisë, me lutjen, me të ardhurit në kishë, ata kanë nevojë ta shikojnë, sepse nuk mësojnë duke u thënë, por mësojnë duke të të parë ty.

Është shumë unike kur ti lexon Fjalën e Perëndisë dhe Perëndia të flet ty personalisht. Është shumë unike kur fëmija lexon Biblën dhe Perëndia u flet atyre personalisht.

Dhe kuptojnë vlerën e Biblës, Fjalës së Perëndisë.

Dhe kuptojnë që mami dhe babi nuk janë të përsosur, por ama ata bisedojnë me Perëndinë dhe Ai u tregon gjëra. *Edhe unë mund të bisedoj me Perëndinë dhe siç u tregon atyre, do të më tregojë edhe mua.*

Nëse shikon që fëmijët ose brezi i ri nuk ka pasion, nuk ka dashuri për Perëndinë dhe Fjalën e tij, duhet të fillojë tek ne, që ta dallojnë këtë pasion dhe dashuri së pari te ne dhe ata ta dëshirojnë duke e parë te ne.

Cila është e dyta? Do e ekspozojmë brezin tjetër për ta parë, për ta ndjerë, për ta përjetuar...

Gëzimin Që Vjen Nga Prania e Perëndisë Në Kishë

Nëse nuk vjen në kishë një të diel, humbet shumë gjëra. Sepse Perëndia të flet duke dëgjuar një mesazh, duke takuar dikë, duke kënduar, duke u lutur me dikë ose për dikë. Dhe kur e merr këtë përjetim dhe e diskuton me familjen çdo javë, kjo është pasuri e madhe.

Të vish në pikën që, brezi i ri apo fëmijët të mos e diskutojnë më “*A Do Shkojmë Në Kishë Këtë Të Diel?*”. Por të jetë bërë aq shumë pjesë e juaj, sa që ata të habiten “*Përse Nuk Po Shkojmë Në Kishë Këtë Të Diel?*”.

Familja ime vjen në kishë edhe atë të diel kur nuk predikoj unë, edhe të dielat kur jam jashtë qytetit.

Është e tyre, sepse e kuptojnë që ata janë kisha, është e tyre. Dhe nuk bëhet pyetja çdo javë “*Si thua, a do të shkojmë në kishë këtë të diel?*”.

Sepse në jetën e përditshme për shumë gjëra ne nuk e bëjmë këtë pyetje. P.sh, të hënën, ndonjë nga të rinjtë, prindërit ose fëmijët a pyet “*A do të shkojmë në shkollë këtë javë?*”. Ose për ne “*A do të shkojmë në punë këtë javë?*”. Ose “*A do të shkojmë në shtëpi sonte apo flemë në rrugë?*”. Këto janë të padiskutueshme.

DHE shumë prindër ose të rinj, e diskutojnë si familje “*Si thoni kalamaja, a doni të shkojmë në kishë këtë të diel?*”. Nëse e kthen në pyetje, bëhet diçka e diskutueshme, pra bëjmë negociata çdo të diel, nëse kjo e diel është një ditë e bukur për të shkuar në kishë ose jo.

Shikoni, nuk dua t’ju rëndo me këtë, por më kuptoni deri në fund. Nëse lihet pas dore të ardhurit në kishë për “x” arsye, “*Sot është ditë e bukur, mos shkojmë në kishë. Sot është ditë me shi, mos shkojmë në kishë. Sot na kanë ardhur miq te shtëpia, mos shkojmë në kishë*”- gradualisht do të kesh një arsye çdo të diel për të mos ardhur në kishë.

Prit. Kur për shumë gjëra të tjera, shkollë, punë nuk e diskuton, por kur vjen puna për të adhuruar Perëndinë bashkë, e kthen në diskutim, e di çfarë do të ndodhë? Do bjerë dëshira, pasioni, do kthehet si gjë për t’u bërë dhe nuk është më prioritet jete, por: *Në kishë shkojmë kur s’kemi çfarë të bëjmë, ose kur s’kemi ndonjë plan interesant për jetën, atëherë shkojmë edhe në kishë.*

Por, eja shkojmë bashkë, si familje, rrimë bashkë në praninë e Perëndisë dhe të njëri-tjetrit, lutemi bashkë, dëgjojmë bashkë, japim bashkë, bëjmë bashkë, marrim bashkë.

Ka bukuri unike kjo e mbledhura bashkë, përjetimi i pranisë së Perëndisë bashkë, kur flasim për këtë gjë bashkë dhe kjo koha bashkë duhet të jetë prioriteti i javës, gjëja kyçe e javës, jo “fundi i kandarit”. “*Po s’pata gjë tjetër do të vij në kishë.*” Por të jetë ditë e veçantë!

Sepse brezi tjetër, në gjërat që do ekspozohen, në gjërat me të cilat ata do e mbushin ditën, si këto gjëra do të bëhen. Nëse i çojmë vetëm në sporte, në kurse apo shkollime, do jenë atletë të mirë, të zgjuar e të shkolluar.

Por kur i ekspozojmë në praninë e Perëndisë dhe familjes së Tij, ata do të kujtohen cila është arsyeja:

Ne si kishë, shërbejmë me pasion që çdo njeri **ta njohë** Jezusin, **të bëhet** më shumë si Ai, **të jetojë** një jetë pa frikë dhe **të sjellë** ndikim pozitiv aty ku është.

Pra, së pari duam që ta njohin Perëndinë vetë, personalisht dhe ta përjetojnë këtë lloj gëzimi vetë, pastaj ta përjetojnë praninë e Perëndisë në kishë. Cila është e treta?

Gëzimi Që Vjen Kur Bën Diçka Për Perëndinë

Sepse po i nxisim të shkëlqejnë në shkollë dhe në shumë gjëra të tjera, por le t'i nxisim që të duan të shkëlqejnë edhe në gjërat e përjetshme. Të bësh për dikë, të ndikosh jeten e dikujt, të ndikosh përjetësinë e dikujt me shërbimin tënd.

Aq seriozisht të duam ta marrin këtë, saqë, kur janë adoleshentë, që në shërbesën e tyre, duam që të drejtojnë dhe të kenë praktikantë. Të drejtojnë, të ndikojnë dhe të bëjnë për dikë.

Sepse duam që të gjithë ta përjetojnë atë gëzimin unik - *“Perëndia më përdori mua, ai personi u ndikua nga mikpritja ime, nga kënga ime, nga shërbimi im, nga kjo nga ajo, nga ajo... u luta për dikë dhe i ndryshoi jeta, i dhashë dikujt një Bibël dhe ai po vjen përsëri në kishë, Perëndia po më përdor mua”*.

Ose një çift po thoshte: *“Janë të habitur familja e vëllait, pse unë dhe burri shkojmë shumë mirë dhe ata kanë tensione në çift dhe u thashë se Zoti e ka përdorur kishën që ne si çift të jemi më të fortë, ejani edhe ju me ne”*.

Shumë nga ju, pasionin, dashurinë që keni për Perëndinë dhe për kishën e keni shumë të dukshme, po ftoni të tjerët dhe vazhdoni ta bëni këtë gjë.

Ka fuqi, ka ndikim kur mblidhemi bashkë, rrimë bashkë apo kur shërbejmë bashkë. Bëjmë gjëra bashkë si një familje e madhe dhe Perëndia përdor secilin prej nesh.

Si ndodhin gjërat e mëdha?

Kur të gjithë bëjnë diçka të vogël, e madhja ndodh vetë.

Dikush fton dikë, dikush bën diçka, dikush jep diçka, dikush ndihmon dikë, dikush rri afër dikujt, dikush lutet për dikë, dikush e mirëpret dhe i buzëqesh dikujt - dikush bën diçka të vogël dhe ndodh vetë gjëja e madhe. Dhe ndërkohë që bëjmë gjëra të vogla, lind diçka brenda secilit, kanë uri më shumë.

“Dua ta njoh Perëndinë më shumë, atij Perëndie që i beson dhe shoku im, shoqja ime, prindërit e mi. Dua të vij në kishën time me gëzim, dua të bëj diçka tek kisha ime me gëzim. Unë nuk jam thjesht pjesëmarrës në kishë, unë jam kisha, dhe jam këtu për të bërë diçka sado e vogël të jetë. Perëndia mund të më përdorë mua për të ndikuar dikë. Dhe në vend që të vij sa për të shtyrë kohën në kishë, unë vij me qëllim.”

SEPSE:

Unë shërbej me pasion që çdo njeri **ta njohë** Jezusin, **të bëhet** më shumë si Ai, **të jetojë** një jetë pa frikë dhe **të sjellë** ndikim pozitiv aty ku është.

Dhe që kjo të ndodhë duhet kontributi i secilit dhe kjo kishë do të jetë gjithë kohës, në çdo brez i zjarrtë për Zotin. Brezi i parë, ashtu edhe brezi i dytë dhe çdo brez pas nesh dhe besimi i secili është i dukshëm!

Kush është gati ta besojë dhe ta praktikojë:

Unë Dua Të Lë Trashëgiminë Time.

Le të lutemi bashkë.